

I nderuar Ministër Bytyqi,

I nderuar z. Marco Mantovanelli, Drejtor i Bankës Botërore për Kosovë e Maqedoni të Veriut,

I nderuari z. Patrick Etienne - Drejtor për Vendin, në Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO)

E nderuar znj. Lori Michealson, përfaqësuese e Ambasadës Amerikane në Kosovë

I nderuar Kryetar i Bordit z. Mrasori,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve financiare,

Të dashur nxënës dhe mësues,

Të nderuar përfaqësues të mediave

Zonja dhe zotërinj,

Kam kënaqësinë e veçantë t'ju dëshiroj mirëseardhje në ngjarjen e sotme të Shënimit të Javës Ndërkombëtare të Parasë në funksion të edukimit financiar me bashkëpunëtorët tonë kryesor Ministrinë e Arsimit, Bankën Botërore, Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Fondin Evropian për Evropën Juglindore, te cilët dëshiroj te shfrytëzoj rastin t'i falënderoj për përkrahjen e rezervë për të avancuar zhvillimet në sektorin financiar në Kosovë në përgjithësi dhe edukimin financiar në veçanti.

Këtë vit, Java Ndërkombëtare e Parasë ka një rëndësi të veçantë për dy arsye:

Njëra për faktin se me aktivitetet që do të zhvillojmë në kudër të kësaj jave, e kemi vendosur Republikën e Kosovës në vëmendjen e arenës

ndërkombëtare me ç‘rast aktivitetet, që do të zhvillojmë këtë javë do të mund të përcillen ndërkombëtarisht përmes “live Streams” nga bankat qendrore, rregullatorë dhe organizata ndërkombëtare që merren me çështjet e edukimit financiar;

Tjetra për faktin tani me të kumtuar nga BQK-ja, që viti 2019 do të jetë viti i mbrojtjes së konsumatorit dhe aktivitetet që do të zhvillojmë në fushën e edukimit financiar do të jenë në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve.

Në mjedisin e sotëm, kur të gjithë jemi dëshmitarë të qëndrueshmërisë financiare që gëzon Kosova, duke vendosur sistemin financiar të Kosovës në nivel të krahasueshëm jo vetëm me vendet e rajonit por edhe të atyre të unionit evropian, çështja e edukimit financiar ka zënë një rol të veçantë në agjendën tonë zhvillimore. Aq më tepër që sektori i shërbimeve financiare ka një peshë të fuqishme në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës, ndërtimin e infrastrukturës vitale dhe zhvillim të qëndrueshëm për Kosovën. Shërbimet dhe produktet e sektorit financiar prekin jetën e secilit qytetar të Kosovës. Prandaj, ne u jemi mirënjohës, të gjithë bashkëpunëtorëve tonë, një pjesë e të cilëve janë sot me ne, për përkrahjen që i kanë ofruar Bankës Qendrore dhe institucioneve tjera relevante në ndërtimin e një tregu financiar, që trajton konsumatorët në mënyrë të drejtë, inkurajon përfshirjen financiare dhe ndihmon qytetarët në përdorimin efektiv të shërbimeve financiare.

Një ndër qëllimet strategjike të BQK-së, është nxitja e zhvillimit të shëndoshë të sistemit financiar në Republikën e Kosovës dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i funksionit të edukimit financiar, me qëllim të krijimit të kulturës së mirëfilltë financiare, që u ndihmon të gjitha palëve të interesit për të marrë vendime të duhura mbi bazën e njohurive të mjaftueshme. Këto njohuri mund të përfitohen vetëm me një edukim adekuat financiar, që rrjedhimisht transformohen në sjellje financiare. Ky do të ishte

realiteti optimal që të gjithë ne sot të pranishëm e aspirojmë, por sa kemi arritur ta realizojmë atë?

Banka Qendrore është duke zhvilluar edukimin financiar në funksion të tri dimensioneve kryesore:

- në funksion të stabilitetit financiar,
- në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve, dhe
- në funksion të gjithëpërfshirjes financiare.

Këto tri dimensione në fakt përshkojnë tërë procesin e aktivitetit financiar, nga ballafaqimi i parë me produkt/shërbim financiar e deri te realizimi i së drejtës/obligimit në këtë raport.

Edukimi financiar në funksion të stabilitetit financiar është i ndërtuar mbi premisën e besueshmërisë së ndërsjellë. Edukimi financiar është thelbi i ndërtimit të besimit. Pa besim nuk mund të ketë stabilitet financiar. Nëse e shikojmë nga perspektiva e mirëqenies sociale, ka shumë rëndësi se a janë qytetarët në gjendje të menaxhojnë në mënyrë të duhur mjetet e tyre financiare. Mirëpo në anën tjetër përfitimet e njohurive financiare shtrihen përtej bilanceve dhe të ardhurave në nivel të individit apo familjes deri te promovimi i një sistemi financiar stabil dhe vendosjes efektive të resurseve brenda ekonomisë reale.

Edukimi financiar në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve është proces aktiv, në të cilin komunikimi i informatave është vetëm fillimi, përderisa qëllimi final është sjellja pozitive financiare afatgjate. Vendimet e konsumatorëve për shfrytëzim të produkteve dhe shërbimeve merren mbi bazën e informacionit të plotë dhe të drejtë, si dhe njohurive që kanë për të kuptuar këto informacione, prandaj edhe shpalosja e tyre nga institucionet financiare

është shumë kritike. Për më tepër qasja e tillë shpie drejt një konkurrence të drejtë të të gjithë akterëve të sektorit financiar. BQK-ja është e përkushtuar të kontribuojë në rritjen ekonomike në vend dhe e përkushtuar të punojë drejt ngritjes së cilësisë në të gjithë sektorin financiar e mbi të gjitha të kontribuojë në mbrojtjen e konsumatorit. Si rezultat me përkrahjen e Fondit Evropian për Evropën Juglindore “EFSE”, do të realizojmë projektin “ Përmirësimi i transparencës së tregut bankar, përmes ndërtimit të Platformës për krahasimin e normave të interesit për bankat”. Kjo platformë do t’ju mundësojë qytetarëve të marrin vendime mbi bazën e informatave të plota dhe të qarta, të shpalosura në një platformë të unifikuar për të gjitha bankat. Gjithashtu kjo platformë do të ndihmojë edhe në rritjen e konkurrencës së shëndetshme në sektorin bankar. Projekti tjetër i rëndësisë së veçantë është Koleksioni i Librave për Edukim Financiar të disenjuara për ciklin e ulët të shkollave fillore, të cilat në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do të shpërndahen nëpër të gjitha shkollat e Kosovës. Nxënësit e shkollave të Kosovës do kenë mundësinë të familjarizohen me konceptet edukative ekonomike-financiare të cilat është e rëndësishme të instalohen në edukimin e hershëm.

Dimensioni i tretë, ai i gjithëpërfshirës financiare është proces i vazhdueshëm i avancimit të infrastrukturës financiare me qëllim të rritjes së disponueshmerisë së produkteve dhe shërbimeve financiare me kosto sa më të ulët. Ndërmjetësimi financiar ka avancuar me shpejtësi nëpërmjet përhapjes së shërbimeve dhe produkteve financiare por vetëm të atyre bazike. Ndërtimi i një tregu financiar që trajton konsumatorët në mënyrë të drejtë, inkurajon përfshirjen financiare dhe ndihmon qytetarët në përdorimin efektiv të shërbimeve financiare, si premisë kryesore e gjithëpërfshirjes financiare. Prandaj BQK-ja ka orientuar programin e edukimit financiar në funksion të gjithëpërfshirjes financiare me qëllim të nxitjes së kërkesës së mjaftueshme për llojllojshmëri dhe shtrirje të gjerë të shërbimeve

dhe produkteve. Prandaj, me përkrahjen e Bankës Botërore dhe Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO), kemi arritur të disenjojmë programin “Greenback Project” që i targeton Remitencat si kategori mjaft e rëndësishme e të hyrave në Kosovë, vetëdijësimin e dërguesve dhe pranuesve të remitencave, në mënyrë që destinimi i kësaj kategorie e të hyrave të transformohet nga konsumi në investim. Gjithashtu Programi i Remitencave dhe Pagesave do të ndihmojë BQK-në të avancojmë tutje infrastrukturën e sistemit të pagesave, në veçanti aspektin e shtrirjes më të gjerë dhe kostos sa më të volitshme për pagesat e vogla.

Të gjithë sot këtu pajtohem se përmes edukimit financiar kemi arritur të adresojmë shumë sfida në kuadër të të tria këtyre dimensioneve, por që ka ende punë për t’u bërë. Sistemi financiar është duke evoluar në vazhdimësi drejt zgjerimit të produkteve dhe shërbimeve financiare më komplekse, prandaj programi i edukimit financiar duhet t’i përgjigjet me proaktivitet këtij dimensionit të ri. Ky proaktivitet imponon nevojën për Strategji Nacionale të Edukimit Financiar, për të cilën strategji konsideroj se është koha që të fillojmë dialogun që tani. Vlerësoj se nënshkrimi i sotëm i Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes të Bankës Qendrore dhe Ministrisë së Arsimit do jetë një fillim i mbarë në këtë drejtim.

Në përfundim, me lejoni të falënderoj Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Bankën Botërore, Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO), EFSE për bashkëpunim të shkëlqyer në realizimin e të arriturave të gjertanishme dhe të gjithë juve përfaqësues të institucioneve tjera relevante për bashkëpunim në të ardhmen.

Ju faleminderit!